

**RAPORTI**

**I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Për Programin e studimit MP në "Marrëdhënie Ndërkombëtare" me profile: a.**

**Studime Mesdhetare; b. Studime Europiane**

**Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë"**

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Dr. Dhurata Milori

PhD Elvin Gjevori

(Korrik/2018)

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MP në "Marrëdhënie ndërkombëtare" me profile: a. Studime mesdhetare; b. Studime europiane

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër Nr.482, datë 03.10.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër Nr.291, datë 11.07.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Marrëdhënie ndërkombëtare me profile: Studime mesdhetare; b. Studime europiane
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 Vit akademik/ 2 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studentëve: 2015 - 2016 2016 - 2017 2017 - 2018	1 student 7 studentë 3 studentë



## **HYRJE**

### **Të dhëna për programin e studimit MP në "Marrëdhënie Ndërkombëtare" me profile: a. Studime Mesdhetare; b. Studime Europiane**

Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" ka filluar aktivitetin me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.177 dt.19.02.2009 si "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë". "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë" është akredituar institucionalisht me urdhër Nr.124 dt 29.03.2012 mbështetur në vendimin Nr.303 dt 13.01.2012.

Me Urdhër të Ministrit Nr. 383 dt. 05.08.2011, mbështetur në VKA Nr. 198 dt. 24.06.2011, "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë" ka riorganizuar programet e saj të studimit. Me Urdhër të Ministrit Nr.124 dt 29.03.2012 mbështetur në VKA Nr. 303 dt 13.01.2012, Institucioni është akredituar institucionalisht dhe në programet Bachelor. Me Urdhër të Ministrit Nr 278 dt 19.05.2017, "Miratimin e Statutit të Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë" institucioni funksionon si Universitet. Institucioni është akredituar instucionalisht nga me VBA Nr. 105, datë 10.11.2017 "Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë".

Programi i studimit MP në "Marrëdhënie Ndërkombëtare" me profile: a. Studime Mesdhetare; b. Studime Europiane është hapur me urdhër Nr. 482 datë 03.10.2011 nga Ministri i Arsimit. Urdhëri i Ministrit bazohej në vendimin Nr. 233 datë 16.09.2011 të Këshillit të Akreditimit. Në fund, bazuar në vendimin e Këshillit të Akreditimit, me urdhër 291 datë 11.07.2012 të Ministri i Arsimit akreditohet programi i studimit MP në "Marrëdhënie Ndërkombëtare" me profile: a. Studime Mesdhetare; b. Studime Europiane për 6 vite me detyrim riakreditimin në përfundim të afatit 6 vjeçar. Bazuar në kërkesën për riakreditimin të programit nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH), ASCAL ngriti grupin e punës të përbërë nga ekspertët e jashtëm Dr. Dhurata Milori dhe PhD Elvin Gjevori. Ekspertët e vlerësimit pasi shqyrtuan dokumentacion e vënë në dipozicion nga institucioni, hartuan një agjendë dy ditore, për vlerësim dhe verifikimin në vend të tij. Agjenda u realizua me sukses në cdo pikë të sajën.

## **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ: Bordi i Akteditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Dr. Dhurata Milori dhe PhD. Elvin Gjevori ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku.

Më datë 26.06.2018 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 03.07.2018 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe vendosën ti marrin në konsideratë dhe ti reflektojnë ato në Raportin përfundimtar.



# ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË


## I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

### Për programin “Master Profesional ne Marrëdhënie Ndërkombëtare, me profil: Studime Mesdhetare”

- a) Të bëhet e mundur angazhimi i profesoriatit shqiptar me tituj akademike.
- b) Të rritet numri i pedagogëve me kohë të plotë.
- c) Të bëhet shumë përpjekje për tërheqjen në këtë program studimi të studentëve më cilësore nga sistemi i studimeve Bachelor.
- d) Të realizohet ngritja e një kampusi studentor me qëllim që Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë të kthehet në një institucion arsimor me karakter mbarëkombëtar, rajonal dhe më gjerë.
- e) Të realizohet përzgjedhja e studenteve që zotërojnë gjuhën angleze ne nivelin e kërkuar për t'iu përshtatur mësimdhënies në këtë gjuhë dhe tregut të punës.
- f) Të rritet numri i moduleve.
- g) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimit duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazen e testeve të njohura ndërkombëtare.

## II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin e parë, institucioni ka rritur numrin e stafit të brendshëm në rang institucional, por edhe të gjithë Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare. Gjithësesi është ende i lartë numri i pedagogëve ende doktorantë. **Rekomandimi është plotësuar kryesisht.**
- b) Për rekomandimin e dytë institucioni ka rritur numrin e stafit të brendshëm në rang institucional, por edhe të gjithë Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare. Rekomandimi është plotësuar kryesisht.
- c) Për rekomandimin e tretë universiteti është përpjekur të rrisë numrin nëpërmjet mesazheve promovuese dhe bursave, **por nuk ka patur shumë sukses.** **Rekomandimi është plotësuar pjesërisht.**
- d) Për rekomandimin e katërt UMSH është transferuar në një godinë të re e cila ofron kushte optimale mësim-dhënieje. **Rekomandimi është plotësuar.**
- e) Për rekomandimin e pestë institucioni na informoi që i ofron studentëve pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare në kuadër të projekteve Erasmus + ku është partner por numri i vogël i studentëve e bën përzgjedhjen më të vështirë. **Rekomandimi është plotësuar kryesisht.**
- f) Për rekomandimin e gjashtë mund të thuhet se është realizuar deri diku me ofrimin e lëndës IR in English si lëndë ekstrakurrikulare. Rekomandimi është plotësuar pjesërisht.
- g) Për rekomandimin e shtatë UMSH bazuar në Udhëzimin nr. 14, datë 28.03.2011, ndryshuar në vazhdim me Udhëzimin Nr. 52, datë 3.12.2015 dhe udhëzimin nr.11, datë 30.6.2016 e ka bërë detyruese që studentët e diplomuar pranë UMSH të shlyejnë detyrimet që rrjedhin nga udhëzimet për mbrojtjen dhe çertifikimin e gjuhës së huaj. **Rekomandimi është plotësuar.**





**Për programin “Master Profesional ne Marrëdhënie Ndërkombëtare, me profil: Studime Europiane”**

- a) Të plotësohen syllabuset e seminareve dhe ushtrimeve.
- b) Të hartohet rregullorja e diplomës (modeli i suplimentit etj).
- c) Të plotësohet organika administrative.
- d) Të merren masat për organizimin konkret të praktikës mësimore;
- e) Të merren masa për përcaktimin e fushave ku mund të zhvillohen mikrotezat dhe të shpallen paraprakisht ato për t'u njohur nga studentët.
- f) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.
- g) Të shihet mundësia e aplikimit të ndonjë kriteri për gjuhën angleze para fillimit të studimit në programin e nivelit të dytë.

**II. Plotësimi i tyre nga Institucioni**

- a) Për rekomandimin “Të plotësohen syllabuset e seminareve dhe ushtrimeve”, institucioni ka realizuar rishikimin e programeve të lëndëve por gjithësesi nuk janë të qartë për leximet specifike që studentët duhet të bëjnë çdo jave dhe për metodën mësimore që do përdoret për çdo leksion e seminar. **Rekomandimin është plotësuar pjesërisht.**
- b) Për rekomandimin “Të hartohet rregullorja e diplomës (modeli i suplementit etj)”, institucioni e ka realizuar një rregullore të tillë dhe e ka vënë në dispozicion të RVJ-së. **Rekomandimi është plotësuar.**
- c) Për rekomandimin “Të plotësohet organika administrative”, UMSH ka rritur numrin e stafit të brendshëm akademik dhe atij administrative. Gjithësesi ende ka një numër të konsiderueshëm pedagogësh me MSc apo që janë doktorantë. **Rekomandimin është plotësuar kryesisht.**
- d) Për rekomandimin “Të merren masat për organizimin konkret të praktikës mësimore, institucioni e ka realizuar me rritjen e numrit të bashkëpunimeve, sidomos me institucione të lidhura me programin e studimit. **Rekomandimi është plotësuar.**
- e) Për rekomandimin “Të merren masa për përcaktimin e fushave ku mund të zhvillohen mikrotezat dhe të shpallen paraprakisht ato për t'u njohur nga studentët” Nëpërmjet udhëzuesit për hartimin e diplomës së ciklit të dytë, që është vënë në dispozicion të RVJ-së. **Rekomandimi është plotësuar.**
- f) Për rekomandimin “Të sigurohet që studentët e këtij programi studimit duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare” UMSH bazuar në Udhëzimin nr. 14, datë 28.03.2011, ndryshuar në vazhdim me Udhëzimin Nr. 52, datë 3.12.2015 dhe udhëzimin nr.11, datë 30.6.2016 e ka bërë detyruese që studentët e diplomuar pranë UMSH të shlyejnë detyrimet që rrjedhin nga udhëzimet e mësipërme për mbrojtjen dhe çertifikimin e gjuhës së huaj. **Rekomandimi është plotësuar.**
- g) Për rekomandimin “Të shihet mundësia e aplikimit të ndonjë kriteri për gjuhën angleze para fillimit të studimit në programin e nivelit të dytë”, institucioni nuk ka marrë ndonjë masë specifike duke qenë që nuk është kërkesë në ligj për MP dhe duke patur parasysh numrin e vogël të studentëve. **Rekomandimi është plotësuar.**



## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane dhe Studime Mesdhetare ka si objekt studimin dhe kërkimin shkencor duke i trajtuar ato në përputhje me zhvillimet globale dhe në përgjigje të nevojave të tregut të punës.

Ky program është pjesë e kurrikulës të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Programi përputhet me planin afatgjatë dhe afatmesëm të Universitetit “ Mesdhetar i Shqipërisë”, në kuadrin e prioriteteve të Integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Ky program studimi është i organizuar në lëndë mësimore të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Programi i studimit është i përqëndruar kryesisht në studimin e çështjeve europiane në aspektin e teorive të integrimit, të drejtën europiane, politikave publike, teorive të administratës, historisë së qytetërimit mesdhetar, sistemet politike të Mesdheut si dhe politikave të Bashkimit Europian në Mesdhe.

Në përfundim të këtij programi mësimor, studentët kanë treguar se me njohuritë e fituara mund të pozicionohen profesionalisht si të punësuar si dhe mund të vazhdojnë studime të thelluara në këtë fushë.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve <sup>1</sup>
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Programi i studimit është hartuar në përputhje me misionin, qëllimin e institucionit si dhe me strategjinë afatshkurter dhe afatgjatë të tij duke u përpjekur të mbajë në konsideratë nevojat e tregut të punës dhe duke pasuaruar programin mësimor me lëndë të cilat plotësojnë nevojat për këto kërkesa. GVJ e gjykon pozitivisht faktin se UMSH kryen rregullisht vlerësime mbi tregun e punës por mendojmë se vlefshëmria e tyre duhet të reflektohet në numrin e studentëve të cilët frekuentojnë këtë program studimi. Programi i studimit mban në konsideratë zhvillimet ekonomike, sociale dhe politike të vendit. Pozicioni i Shqipërisë dhe marrëdhëniet e saj rajonale si dhe me vendet e Bashkimit Europian përditësohen dhe pasqyrohen në
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	

<sup>1</sup> GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmblodhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.



	<p>programin e studimit. Konstatohet se numri i ulët i studentëve këtë vit, duke patur parasysh se në profilin Studime Mesdhetare nuk ka patur studentë të regjistruar, dhe mendojmë se nevojat e tregut duhen marrë më tepër në shqyrtim dhe duhen pasqyruar në përmbajtjen e programit mësimor.</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane, Studime Mesdhetare është përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit. Objektivat e programit të studimit janë të përshtatura dhe të integruara me strategjinë për zhvillim të institucionit të cilët janë të matshëm dhe të realizueshëm prej tij. Programi mundëson studimin teorik në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë, për ti përgatitur studentët si specialistë të aftë që të punojnë në fushat përkatëse (Aneks/Shtojcë, Struktura e Programit MP. Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë)</p>
<p><b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Përmbajtja dhe emërtimi i programit të studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane; Studime Mesdhetare është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, përkatësisht: Ligji për Arsimin e Lartë Nr.80/2015, Standartet Shtetërore të Cilësisë për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Udhëzimet e Minisrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Karta e Bolonjës, Zona Europiane e Arsimit të Lartë. Ky program studimi i përket nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.</p>
<p><b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>“Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”, ka një plan strategjik i cili synon përmirësimin e programeve të tij të studimit mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Strategjia është në përputhje me prirjet kryesore të zhvillimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri dhe Europë.</p> <p>Qëllimi i planit strategjik përmbledhet në përmirësimin e standarteve dhe rezultateve të mësimdhënies nga ana e pedagogëve dhe të</p>



	nxënit prej studentëve në këtë Universitet. Nëpërmjet këtij procesi synohet aftësimi sa më i madh i studentëve për tregun e punës.
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>GVJ vlerëson se programi i studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil Studime Europiane; Studime Mesdhetare zhvillohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</p> <p>Ky program është në përputhje si me kuadrin ligjor në fuqi ashtu edhe me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p> <p><b>Rekomandojmë</b> që të bëhet një studim më i plotë i tregut për ta reflektuar atë në mënyrë sa më të plotë në programin mësimor si një instrument për të rritur numrin e studentëve të regjistruar në këtë program.</p> <p><b>Standardet plotësohen kryesisht.</b></p>	

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë përbëhet nga tre fakulteteve të cilët ishin riorganizuar në: Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, ky i fundit nga informacioni i vënë në dispozicion nga ASCAL dhe takimeve të realizuar me titullarët e universitetit ishte në proces akreditimi. Fakulteti i shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ishte riorganizuar dhe përbëhej përkatësisht nga tre departamente:

- Departamenti i të Drejtës Publike
- Departamenti i të Drejtës Civile
- Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare synon të përgatisë profesionistë sa më të aftë në fushën e drejtësisë, diplomacisë, administratës publike si dhe fusha të tjera të përafërta me to. Fakulteti synon të nxisi te studentët mendimin kritik si dhe të zhvillojë më tej kërkimin shkencor.

Ristrukturimi i Fakultetit, Departamenteve dhe programit të studimit është kryer për të realizuar rritjen e cilësisë së studimit.

Fakulteti i shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ofron 2 programe studimi të Ciklit të Parë (Bachelor); 3 programe studimi të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (MSH), 1 program të Ciklit të Dytë Master Profesional me dy profile (MP). Në Masterin Profesional Marrëdhënie



Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane; Studime Mesdhetare janë të angazhuar 9 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 2 PAK. PAE mbulojnë 78% të ngarkesës dhe PAE 22% të ngarkesës.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

**Struktura akademike e Fakultetit**

Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është një prej tre fakulteteve që përbejnë UMSH.

Fakulteti përbëhet nga tre departamente me një numër total prej 37 pedagogësh, prej të cilëve 26 personel akademik efektiv dhe 11 personel akademik me kontratë. Departamentet të cilët përbëjnë këtë fakultet janë: Departamenti i të Drejtës Publike, Departamenti i të Drejtës Civile dhe Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka në përbërje gjithsej 13 pedagogë, prej të cilëve 8 personel akademik efektiv dhe 5 personel akademik me kontratë. Departamenti i të Drejtës Civile ka në përbërjen e tij 11 pedagogë prej të cilëve 9 personel akademik efektiv dhe 2 pedagogë personel akademik me kontratë. Departamenti i të Drejtës Publike ka në përbërje gjithsej 13 pedagogë, prej të cilëve 9 personel akademik efektiv dhe 4 personel akademik me kontratë.

Secili nga departamentet ka në përbërjen e tij të paktën nga 7 anëtarë efektiv si personel akademik dhe nga të cilët 3 anëtarë të personelit janë me gradën shkencore “Doktor” në përputhje me Ligjin 80/2015.

Rektori, zv/rektori, dekani dhe shefat e departamenteve janë organet drejtuse të fakultetit të emëruar sipas Ligjit Nr.80/2015 për Arsimit e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë dhe janë punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane; Studime Mesdhetare. Rektori mban titullin Prof. As., Dekani i Fakultetit mban titullin Prof. Dr dhe shefi i Departamentit mban gradën PhD.

Në përputhje me rregulloren e programit të studimit MSC në Marrëdhënie Ndërkombëtare neni 6 shefi i departamentit është përgjegjës për programin e studimit.

**Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës**

Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare përbëhet nga 13 pedagogë gjithsej prej të cilëve 8 janë personel akademik efektiv dhe 5 personel akademik me kontratë. Nga stafi akademik efektiv 3 prej tyre kanë tituj dhe gradë shkencore, ndërsa nga personeli akademik me kontratë 4 pedagogë kanë tituj dhe gradë shkencore.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

➤ Tabelat e përditësuara të stafit akademik të departamentit

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Bazuar në Ligjin Nr 80/2015 datë 22.07.2015 “ Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është angazhuar të plotësojë detyrimet që rrjedhin prej tyre. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka në strukturën e tij tre Fakultete: Fakulteti i Shkencave Ekonomike; Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare përbëhet nga tre departamente: Departamenti i të Drejtës Publike; Departamenti i të Drejtës Civile dhe Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Bazuar në dokumentacionin e vetëvlerësimit dhe rekomendacionin shtesë të marrë gjatë vizitës rezultojnë se; Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka në përbërjen e tij 8 anëtarë efektiv si personel akademik efektiv me kohë të plotë ndër të cilët 3 me gradën shkencore PhD dhe një me gradën shkencore Dr. (Referuar Aneks/ Shtojcë, Lista e stafit akademik e programit MP Marrëdhënie Ndërkombëtare me Profile)</p>
---	--

**Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Mbështetur në Rregulloren e programit MP në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane; Studime Mesdhetare, neni 6, përgjegjësi i Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare është autoriteti përgjegjës për programin e studimit Masterit Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare. Në përbërjen e njësisë bazë dhe kryesore janë përfshirë edhe lektorë të cilët janë personalitete të fushës si dhe kanë përvojë të gjatë në mësimdhënie. Përfshirja e këtyre figurave në këtë program studimi, rrit cilësinë e mësimdhënies, duke ndikuar kështu në një formim sa më të mirë të studentëve.</p> <p>Mbështetur në Statutin e Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë", neni 55, njësitë bazë dhe kryesore të institucionit përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p> <p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (RVB), takimet që realizuam me titullarët e Institucioni dhe Zyrën e burimeve Njerezore, vumë re që, procedura e rekrutimit ishte transparente. Institucioni bënte publikimin e kriterëve në faqen e tij në internet në bazë të nevojave që kishte Departamenti. Më pas ngrihej një komision i cili zakonisht përbëhej nga 3 persona. Kandidari</p>
--	---



kalonte 2 intervista, e para ishte e përgjithshme dhe e dyta ishte ajo ku Institucioni i përcaktonte detyrat dhe lënët që do të mbulonte në programin e studimit.

### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë përbëhet nga tre fakulteteve. Fakulteti i shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ofron 2 programe studimi të Ciklit të Parë (Bachelor); 3 programe studimi të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (MSH), 1 program të Ciklit të Dytë Master Profesional me dy profile (MP). Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është përkushtuar në bazë të kërkesave ligjore të përmbushë misionin e tij në lidhje me këtë program studimi. Përbërja e njësisive bazë dhe përgjegjëse është konform kërkesave ligjore (Neni 25, pika 4 e Ligjit 80/2015).

Institucioni ndjek procedura transparente për rekrutimin e stafit të ri akademik, ku pjesë e trupit vlerësuas është gjithmonë një anëtarë nga departamenti.

Stafi akademik plotëson kërkesat ligjore qoftë në rekrutim por edhe në plotësimin e kërkesave dhe kualifikimeve akademike për fushën e mësimdhënies. Angazhimi në këtë program studimi i personaliteteve në fushën e diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare mbetet një vlerë e shtuar për programin e studimit.

**Standardet plotësohen plotësisht.**

### **3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Kategoritë kryesore të personelit akademik të Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare bazuar në Statutin e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë si dhe në Rregulloren e Programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare ndahet në tre kategori kryesore të cilat janë: personeli akademik, personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe personeli administrativ. Personeli akademik ndahet në dy kategori kryesore: personel akademik efektiv dhe personel akademik me kontratë. Personeli akademik efektiv përbëhet nga drejtuesit dhe stafi akademik i brendshëm. Personeli akademik me kontratë përbëhet nga stafi akademik i jashtëm dhe lektorët e ftuar. Veprimtaria e mësimdhënies, udhëheqjes shkencore, kërkimit shkencor, këshillimit për studentët, detyrat dhe shërbimet në funksion të zhvillimit të institucionit si dhe disa detyra me karakter administrativ, kryhen nga stafi personel akademik dhe drejtuesit akademik. Për të përzgjedhur personelin akademik zhvillohet konkursi i parashikur në Statutin e UMSH si dhe në Rregulloren e Programit të Studimit. Në komisionin i cili përzgjedh nëpërmjet konkursit kandidatët marrin pjesë Rektori i UMSH, Dekani i Fakultetit dhe ose/përgjegjësi i Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare si dhe një përfaqësues i Qendrës “ Mesdheu”.



### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat. Aneks/ Tabela nr. 1
- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre Aneks/ Tabela nr. 2

Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare i cili është përgjegjës për këtë program studimi ka në përbërjen e tij 13 pedagogë nga të cilët 8 PAE dhe 5 PAK. Stafit PAE përbëhet nga 2 PhD, 1 Dr, 2 Dr në proces dhe 3 Msc. Stafit PAK përbëhet nga 1 Prof. Dr., 2 Prof. As, 1 Dr. Dhe 1 Msc. Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore “PhD”. Në programin e studimit MP Marrëdhënie Ndërkombëtare, gjatë vitit akademik 2017-2018 janë angazhuar 9 pedagogë, nga të cilët 7 PAE dhe 2 PAK. Një pjesë e lëndëve në programin e në Marrëdhënie Ndërkombëtare mbulohen nga stafi akademik i departamenteve të tjera të Fakultetit.

Ngarkesa e personelit akademik përbëhet prej 3 komponentësh: a) mësimdhënie; b) punë kërkimore shkencore; c) punë në mbështetje të institucionit (punë administrative). Sipas të dhënave, ngarkesa mësimore për programin e studimit Marrëdhënieve Ndërkombëtare për vitin akademik 2017-2018 mulohet në masën 78% nga PAE dhe 22% nga PAK. Edhe në verifikimin e kontratave të punës secili anëtar i personelit akademik gjatë vizitës në Institucion, në varësi nga titulli dhe funksioni, kishte të specifikuar detyrat, angazhimet dhe përgjegjësitë.

Departamenti ka mbajtur në konsideratë përputhshmërinë e lëndëve me formimin profesional dhe akademik të pedagogëve. Qëndrueshmëria e stafit vjen duke u konsoliduar prej vitit akademik 2012-2013 deri në vitin akademik 2017-2018, subjekt i këtij raporti vlerësimi. Njëkohësisht prej vitit akademik 2012-2013 deri në vitin akademik 2017-2018 vërehet se stafi akademik është plotësuar me grada shkencore duke patur pjesë të saj dhe profesorë me eksperiencë të gjatë akademike e profesionale.

Nga zyra e burimeve njerëzore / personelit u informuam se kriteret kryesore të zgjedhjes së stafit akademik janë klasike, - lidhen me përvojën, CV profesionale, titujt akademikë, fushën e kërkimit, etj. Për vetë natyrën e universitetit, specifikisht kërkohen njohuri të thelluara. Përsa i përket % së punësimit të stafit PAE në raport me PAK në vitin akademik 2017-2018 është ruajtur një balancë rreth 60% PAE në raport me 40% PAK të angazhuar për këtë program studimi. Një balancë e ngjashme është ruajtur dhe në vitet akademike 2016-2017 dhe 2015-2016. Numri më i lartë i % së punësimit me PAE ka qenë viti akademik 2012-2013 ku raportit ka qenë 70% PAE në raport me 30% PAK. Përqindja më e ulët e punësimit të PAK në raport me PAE është në vitin akademik 2014-2015 përkatësisht 54% PAE në raport me 38 % PAK. Rekrutimi i personelit akademik realizohet nën drejtimin e njëjësive bazë dhe kryesore, duke u bazuar në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit në përvojën akademike dhe eksperiencën në fushat përkatëse. Ngarkesa mësimore mbulohet brenda normave të përcaktuara në ligj, 70% nga personeli akademik efektiv dhe pjesa tjetër nga stafi akademik me kontratë.

Kontrata e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat Bazuar në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë LIGJ Nr. 7961, datë 12.7.1995, Ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.3.1996, Ndryshuar me ligjin nr.9125, datë 29.7.2003, Ndryshuar me ligjin nr.10 053, datë 29.12.2008, Ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015 I përditësuar, Ligjit Nr 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit dhe Rregullores Organizative të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë përcaktohen të drejtat dhe detyrat e pedagogut të cialt burojnë nga kontrata e punës. Në kontratat e punës të vëna në dispozicion nga UMSH janë përcaktuar koha e fillimit të marrëdhënies të punës, kohëzgjatja e kontratës së punës, përshkrimin e punës, kohëzgjatja e pushimeve të paguara, orët e punës, zgjidhja e kontratës së punës. Kontrata



shoqërohet me anekse përkatëse ku parashikohen detyrat administrative, vlerësimi i punës, raporti për punën shkencore dhe detyrimet funksionale për stafin akademik.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit Aneks/ Tabela nr. 3

Këshilli shkencor përbëhet nga tre anëtarë. Alketa Elezi është drejtuese e Këshillit Shkencor dhe mban gradën shkencore Prof.As. Edon Qesari është anëtar i Këshillit Shkencor më gradën shkencore Phd. Kosta Gazeli është në pozicionin e anëtarit të Këshillit shkencor dhe mban gradën Prof. As.

Të dhënat sipas seksit

Në departamentin e marrëdhënieve ndërkombëtare japin mësim 7 pedagogë meshkuj dhe 6 pedagoge femra. Në stafin e personelit akademik efektiv japin mësim 3 pedagogë meshkuj dhe 5 pedagoge femra, ndërsa në personelin e stafit akademik me kontratë japin mësim 4 pedagogë meshkuj dhe një femër. Në këtë raport të përgjithshëm të departamentit vëmë re se është ruajtur një balancë gjinore në punësim.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë .

Stafi ndihmës administrativ përbëhet nga punonjës të cilët gëzojnë minimalisht diplomën Bachelor. Një pjesë e tyre kanë studiuar pranë UMSH. Stafi ndihmës në nivel departamenti plotëson kriteret e vendosura nga institucioni bazuar dhe në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik angazhohet në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe plotësimin e tyre duke u konsultuar me ekspertë të ndryshëm në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe duke i kushtuar rëndësi kurrikulave të institucioneve të tjera homologe me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.</p> <p>Personeli ndihmës administrativ mbështet në mënyrë të vazhdueshme realizimin e planit mësimor si dhe punën e personelit akademik për të krijuar kushtet e përshtatshme në realizimin e planit mësimor. Në këtë kuadër biblioteka është vënë në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve për të ofruar literaturën e nevojshme si dhe ambiente studimi. Sekretaria mësimore, arkiva, shërbimi i informacionit, mirëmbajtja e faqes së institucionit janë plotësisht në shërbim të këtij qëllimi.</p> <p>Personeli akademik, ndihmës-mësimor shkencor dhe administartiv i institucionit për programin Master Profesional ne Marrëdhënie Ndërkombetare me profil: Studime Europiane; Studime Mesdhetare zhvillohet në përputhje me objektivat dhe strategjinë e Univeristetit</p>



	"Mesdhetar I Shqipërisë" duke e mbuluar ngarkesën e këtij programi studimi me 70% të stafit të brendshëm në vitet akademike.
<b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Procesi i hartimit dhe miratimit të kurrikulave është i bazuar tek parimet dhe kriteret e Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, standardet shtetërore të cilësisë, Statuti dhe Rregullorja e UMSH.</p> <p>Procesi i diskutimit dhe hartimi i kurrikulave për programin mësimor Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare realizohet në Departament si njësi bazë përgjegjëse për realizimin e programit mësimor. Personeli akademik dhe përkatësisht pedagogu i lëndës është përgjegjësi kryesor për hartimin e kurrikulës. Pedagogu propozon programin e lëndës i cili miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit. Pedagogu përditëson programin e lëndës duke u bazuar të ngjarjet apo dukuritë shoqërore e politike të cilat gjykohen prej tij se janë të rëndësishme për tu trajtuar. Përditësimi ndodh duke marrë në konsideratë dhe literaturën bashkëkohore në fushën përkatëse.</p> <p>Rekrutimi i personelit akademik realizohet në përputhje me aktet ligjore dhe kriteret e parashikuara në statutin e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë dhe Rregullores së programit mësimor. Rekrutimi është një procedurë e hapur dhe transparente e cila bazohet ne nevojat e institucionit për staf akademik dhe kualifikimeve të kandidatëve për pedagog.</p>
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të</p>	<p>Rekrutimi i personelit akademik bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe bazuar në kriteret e parashikuara në Statutin dhe rregulloren e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, përkatësisht neni 38, 39 dhe 40.</p> <p>Kërkesa lind nga Departamenti i cili në fillim të cdo viti akademik parashtron nevojat për staf akademik me kohë të plotë ose të pjesshme në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore Kërkesa e miratuar nga Dekani dhe Rektori I UMSH publikohet në faqen zyrtare të Universitetit (ëëë.umsh.edu.al ).</p> <p>Ngarkesa mësimore në këtë program studimi mbulohet në masën 78% nga stafi akademik i brendshëm efektiv dhe 22% nga stafi me kontratë.</p> <p>Vlerësimi i stafit realizohet duke u bazuar në kërkesat ligjore, duke u bazuar gjithashtu dhe në</p>



<p>njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>performancën e vazhdueshme të pedagogut si në mësimdhënie, në angazhimin e tij me studentët, në pasurimin e programit por dhe angazhimin e tij në aktivitete kërkimore dhe shkencore. Vlerësimi i performancës së pedagogut konsiston në vlerësimin 360 gradë, ku pjesë e vlerësimit për pedagogun janë studentët, kolegët, shefi i departamentit, dekani, burimet njerëzore si dhe vetvlerësimi i tij.</p> <p>Nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion si edhe nga verifikimi i dosjeve që realizuam në Institucion, konstatojmë se, Zyra e Burimeve Njerëzore mban bazë të dhënash për personat e rekrutuar si dhe njoftimet për vendet vakante.</p>
---	---

**Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.**

<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve përëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi i programit të studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane; Studime Mesdhetare, është shefi i departamentit i cili mban gradën shkencore "Doktor" (PhD) të fituar në një Universitet Europian.</p> <p>Në programin e studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane; Studime Mesdhetare, të gjithë Lektorët të cilët janë titullarë të lëndëve që ofrohen nga ky program kanë të paktën gradën shkencore "Doktor". Titullarë të lëndëve të caktuara janë edhe personel akademik efektiv dhe personel akademik me kontratë. Theksojmë se pjesë e personelit akademik me kontratë janë pedagogë me grada shkencore Prof.Dr, Prof Asoc. Dr si dhe Dr. Rektori, zv/rektorotër, dekani, përgjegjësi i departamentit janë të punësuar pranë UMSH me kohë të plotë.</p> <p>Institucioni në bashkëpunim me departamentin vënë në dispozicion personel për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. Pedagogët e këtij programi mësimor angazhohen në realizimin dhe ndjekjen e praktikave mësimore të studentëve. Një risi e Universitetit e cila na tha në disa prej takime që ne realizuam, ishte praktika duke filluar nga ky vit akademik ishte bërë me note. Kjo nisëm ishte ndërmmarrë pas disa sygjërimeve që institucioni kishtë marrë nga aktorë të ndyshëm.</p> <p>Për shkak të numrit shumë të ulët të studentëve nuk ka ngrkesë për pedagogët në mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e praktikave profesionale</p>
---	---

**Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.**



<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p>	<p>Në realizimin e punës së diplomës Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare, cdo student ndiqet nga një pedagog I departamentit. Udhëheqja realizohet nga ata pedagogë të cilët janë ekspertë të fushës ku është propozuar tema e diplomës master professional.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p>	<p>Të gjitha aspektet të cilat përfshijnë punimin, udhëheqjen dhe mbrojtjen përfshihen në Aneks/Shtojce 8 “Udhëzim për punimin e diplomës programit, MP. Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile, Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” Udhëheqësi shkencor ka të paktën gradën shkencore “Doktor” si një nga kriteret e mirëpërcaktuara ligjore.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Numri i studentëve të udhëhequr nga pedagogu në këtë rast nuk shihet si problematik duke marrë në konsideratë numrin shumë të ulët të tyre në këtë program studimi.</p>
<p><b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p>	<p>Pedagogu që ngarkohet për të drejtuar studentit për përgatitjen e temës së diplomës janë njohës së mirë të fushës si në aspektin akademik por edhe në eksperiencat praktike ku mund të jenë përfshirë në çështje të caktuara.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Udhëheqësit kanë njohuri të avancuara në fushën në të cilën është parashikuar të hartohet teza e diplomës. (Aneks/Shtojce 8 “ Udhëzim për punimin e diplomës programit, MP. Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile, Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”)</p>
<p><b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p>	<p>Personeli ndihmës akademik angazhohet për t’ju vënë në dispozicion studentëve laboratorin e informatikës dhe sistemin audio-viziv në cdo sallë ku zhvillohen leksione dhe seminare. Aksesit në bibliotekë është i plotë për studentët. Burimet njerëzore vihen në dispozicion për përmbushjen e objektivave të këtij programi duke përfshirë dhe personelin akademik dhe ndihmës akademik</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p><b>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p>	<p>Ngarkesa mësimore përcaktohet dhe llogaritet duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ngarkesa mësimore për cdo pedagog përcaktohet në fillim të cdo viti akademik bazuar në Rregulloren Administrative të UMSH, neni 20.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga</p>	



<p>personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Duke ju referuar takimeve të zhvilluara në kuadër të vizitës për vlerësimin e jashtëm nga institucioni na informoi se ngarkesa mesimore për cdo pedagog është jo më shumë se 270 orë dhe pedagogu nuk mund të mbulojë më shumë se katër lëndë mësimore. Ngarkesa mësimore dhe organizimi e drejtimi i tyre për programin e ciklit të dytë të studimit, vlerësohet me orë mësimore.</p>
<p><b>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>UMSH disponon një bazë të dhënash të hollësishme për personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe të personelit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Kjo bazë të dhënash menaxhohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Nga vizita në këtë zyrë pamë se dosjet e stafit akademik ishim të plota dhe mbanin të gjithë informacion e nevojshem. Nga përgjegjesja e zyrës na u konfirmua gjithashtu se kontaktat e personelit akademik hartoheshin në përputhje me ligjin 80/2015, rregulloren dhe statutin e UMSH.</p> <p>Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik dhe ndihmës për programin e studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane; Studime Mesdhetare. Institucion, publikon kriteret dhe procedurat për rekrutim të personelit akademik në: faqen e universiteti, revistën e shkollës si dhe në shtypin e shkruar dhe elektronik. Si fillim bëhej një seleksionimi kandidatëve/aplikuesve mbi bazën e plotësisht të kriterëve dhe me pas ngrihej komisioni i cili do të intervistonte ata.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>UMSH ka realizuar në mënyrë transparente procedurat e rekrutimit të personelit akademik dhe mbështetës në përputhje me kriteret ligjore, Statutin dhe Rregulloren e institucionit.</p> <p>Në vijim punohet me afate të përcaktuara për kualifikimin e mëtejshëm shkencor të personelit.</p> <p>Institucioni ka në përbërje të tij elementë të stafit akademik të kualifikuar dhe me përvojë të gjatë në fushën e studimit i cili përbën një vlerë të shtuar për institucionin. Duke mbajtur në konsideratë kërkesat dhe nevojën e vazhdueshme për staf të kualifikuar dhe për përsosjen e programeve mësimore, Institucioni ndjek praktika pozitive për nxitjen e kualifikimit të stafit por edhe për përthithjen dhe rritjen e interesit të sa më shumë studentëve në këtë fushë.</p> <p>Institucioni ka të ndërtuar një bazë të plotë të dhënave për personelin e tij.</p> <p>Institucioni ka angazhuar personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij. Stafi ka një qëndrueshmëri ndër vite dhe plotëson kërkesat për tituj shkencorë.</p> <p><b>Standartet plotësohen plotësisht.</b></p>	



#### **4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe të kriterëve të udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Arsimit, Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" ushtron aktivitetin e tij në një sipërfaqe prej 3860 m<sup>2</sup>. Mësimi zhvillohet nga dita e Hënë deri të Shtunën nga ora 8:00- 21:00.

Universiteti pozicionohet në një zonë universitare rrethuar nga universiteti publik dhe universitet privat.

Lëvizja dhe aksesin në godinë lëhtësohet dhe nga ashensorët funksionalë, duke mundësuar aksesin edhe të personave me aftësi të kufizuara.

Godina në të gjithë shtrirjen e saj është e pajisur me mjete për ndricim alternativ, rezerva të konsiderueshme uji, sistem kondicionimi modern gjatë gjithë vitit i shtrirë në të gjitha ambientet, internet, vende clodhjeje, projektore, sistem mbrojtjeje nga zjarri.

##### **Ambientet mësimore, laboratorët, zyrat e pedagogëve**

Pesëmbëdhjetë (15) sallat e seminareve kanë kapacitet prej 30-45 vende ulëse në një sipërfaqe prej 35-55 metër katror secila. Labororet kanë 25-45 poste të pajisura me teknologjinë e nevojshme për zhvillimin e punës laboratorike sipas specifikave (kompjuter, sistem audio, paste të ndara, etj)

Sallat dhe zyrat e personelit akademik janë të pajisura në funksion të krijimit të kushteve optimale të punës kërkimore dhe shkencore të personelit akademik Sallat dhe zyrat janë të ndricuara dhe të pajisura me teknologji bashkëkohore komunikimi audioviziv.

##### **Biblioteka**

Sallat e Bibliotekës dhe Sallat e leximit janë të ndricuara, me sistem ngrohje e ftohje dhe plotësojnë të gjitha standardet për punën në bibliotekë.

Biblioteka e Universitetit "Mesdhetar të Shqipërisë" është e pajisur me literaturë bashkëkohore të fushave të ndryshme me mbi 4000 tituj librash dhe tekstesh universitare, revista shkencore si dhe materiale të tjera shkencore, të ndara sipas drejtimeve: Ekonomi; Finance, Kontabilitet, Banka, Makro-Mikro, Statistike, Marketing, Biznes, Menaxhim, Turizem; Pedagogji; Letërsi, Fjalor, Anglisht, Pedagogji; Biznes; Organizim, Taksa, Transaksione, Pasuri e Paluajtshme, Kredi-Debi.

Ambjentet e bibliotekave dhe leximit variojnë nga 20 - 90 m<sup>2</sup>, të pajisura me poste leximi dhe studimi dhe PC me shërbim internet.

##### **Zyrat e Personelit Akademik, Administrativ dhe Teknik, Sekretaria Mësimore, Arkiva e Protokolli**

Për mbarëvajtjen e punës, ambientet janë të pajisura me teknologjinë e nevojshme bashkëkohore (kompjuter, pajisje fotokopjimi, mjete kancelarie, etj.)

Zyra e pranimit dhe e sekretarisë janë pozicionuar në hyrje për të dhënë shërbimet dhe kujdesin ndaj studentëve, pedagogëve dhe të interesuarve.



Zyrat e tjera si Financa, Këshilli Studentor, Burimet Njerëzore, Kërkimi Shkencor, Marrëdhëniet me Jashtë, IT, Laboratorët e Teknologjisë së Informacionit, Zyra e Këshillimit të Studenteve dhe e Karrieres, funksionojnë mbi të njëjtat standarte.

### Akresi në internet

Ne funksion të studentëve dhe stafit në të gjithë hapësirat e UMSH është instaluar shërbim internet Wireless (WiFi) me shërbim interneti 24 orë.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Mjediset për Programin e studimit
- Salla për leksione
  - Klasa për seminare
  - Salla për aktivitete promovuese
  - Salla për praktikë lëndore/ profesionale
  - Laboratorë për lëndët
  - Laboratorë informatike
  - Salla interneti
  - Salla për bibliotekë
  - Mjedis për fotokopjime, librari etj
  - Zyrë informacioni për studentët
  - Nyje hidrosanitare
- Mjediset për stafin:
- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
  - Zyra për sekretarinë mësimore
  - Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
  - Zyra për personelin akademik

Gjatë vizitës u konstatua se personeli akademik ka mjedise të mjaftueshme dhe komode pune, ka akses në internet.

<b>Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit</b>	<b>Sasia</b>	<b>Sipërfaqja</b>
Salla për leksione	6	563.5
Klasa për seminare	15	598.1
Salla për aktivitete promovuese	1	104
Laboratorë informatike	3	144
Salla internet	1	52
Salla për bibliotekë	4	157



Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	15
Zyrë informacioni për studentët	1	14
Korridore/holle	10	680
Mjedise sportive	0	
Mjedise shërbimi për të tretë	2	90
Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore	1	12
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj	1	430
Nyje hidrosanitare për studentët	53	203.4
<b>Norma m<sup>2</sup>/për student</b>	<b>5.395</b>	

<b>Mjediset për stafin:</b>	<b>Sasia</b>	<b>Sipërfaqja</b>
Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin	7	170.5
Zyra për sekretarinë mësimore	3	48
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	8	262.6
Zyra për personelin akademik	2	52.6
Zyrë për financën	1	30
Zyrë për Njësinë e SBC	1	25.5
Salla për mbledhje	1	58
Mjedis për stafin e shërbimit	2	64
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	5	25.8
Arkiva	2	50
<b>Norma m<sup>2</sup>/për person</b>	<b>5.1</b>	



## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Univeriteti Mesdhetar i Shqipërisë e ushtron aktivitetin mësimor në një godinë të marrë me qera. Infrastruktura dhe shërbimet e vëna në dispozicion janë optimale për zhvillimin sa më cilësor të mësimin dhe të kërkimit shkencor. Institucioni disponon një godinë qendrore për zhvillimin e aktiviteteve të tij si edhe një godinë shtesë të ndërtuar vitet e fundit.</p> <p>Institucioni garanton të gjitha kapacitetet dhe mjediset e mjaftueshme për realizimin e të gjithë Programeve të Studimit.</p>
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane; Studime Mesdhetare, UMSH vë në dispozicion të studentëve literaturën bazë dhe ndihmëse të përcaktuar në syllabuset e lëndëve. Një mënyrë efikase për përditësimin me literaturën më të re e ofron dhe biblioteka elektronike e Universitetit.</p> <p>Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar cdo vit për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim.</p> <p>Cdo vit një pjesë e buxhetit shkon në pasurimin e titujve të librave që ndodhen në bibliotekë</p> <p>Oraret e bibliotekës afishohen në mjediset e bibliotekës si dhe në faqen zyrtare të UMSH.</p> <p>Ajo cka u vu re ishte një frekuentim i ulët nga ana e studentëve.</p>
<b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</b>	



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Nga vëzhgimi në terren dhe duke e verifikuar me të dhënat e institucionit konstatojmë se UMSH vë në dispozicion të stafit dhe studentëve salla të mjaftueshme leksionesh dhe seminaresh. Në të gjitha sallat ka sisteme kondicionimi, mjetet e nevojshme audiovizive, shërbim interneti, mbulim me sinjal WiFi, tabela shpjeguese.</p> <p>Gjithashtu konstatojmë se pajisjet ndihmëse si monitorë dhe kompjutera në salla leksionesh dhe seminaresh funksiononin dhe na u bë me dije se studentët i përdornin për prezantimet individuale dhe në grupe për detyrat e kurseve.</p> <p>Institucioni ofron ambiente me standart të lartë që lehtësojnë punën mësimore, kërkimore e shkencore. Programi Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane; Studime Mesdhetare nuk parashikon praktika laboratorike.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>UMSH në realizimin me sukses të programi të studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane; Studime Mesdhetare siguron literaturë bazë dhe plotësuese si dhe pasuron periodikisht me tituj të ri librash dhe në formë elektronike në gjuhën shqipe dhe të huaj bibliotekën e shkollës. Biblioteka dhe sallat e studimit janë lehtësisht të aksesueshme për studentët dhe stafin akademik. Të gjitha mjediset mësimore janë pajisur bazuar në kërkesat dhe standartet shtetërore të cilësisë</p> <p><b>Standardet plotëson plotësisht.</b></p>	

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) është pjesë e OJF “Qendra Mesdheu” e cila është regjistruar si person juridik pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt veprimi ofrimin e ëhsërbimeve në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Bordi i Qendrës “Mesdheu” emëron Bordin e Administrimit që ka për detyrë mbarëvajtjen financiare dhe i përgjigjet Qendrës për këtë. Oragni më i lartë vendim-marrës përsa i përket mbarëvajtjes financiare është bordi i Qendrës Mesdheu. Sipas të dhënave në RVB, specifikisht tanela 8 në faqe 33, me përjashtim të vitit 2017, pjesa dërrmuese e burimeve financiare të universitetit vijnë nga tarifat shkollore. Burimet financiare kanë ardhur në rritje progresive cdo vit duke u rritur nga 93,332,000 lekë në 2012 në 298,606,000 në 2017. Në 2017 universiteti përfitoi 1,599,000 lekë nga grantet për kërkime dhe kontratat si dhe 3,362,000 nga aktivitet tregëtare si kafe, menca etj. Po sipas RVB-së kostoja e studentit për vitin akademik 2017-2018 është 137,000 lekë nga 257,000 që ishte në vitin akademik 2011-2012. Teksa universiteti është



zgjerruar dhe ka mundur të aplikojë konceptet e “ekonomisë së shkallës” kostoja e shërbimit ka rënë duke përmirësuar stabilitetin financiar. Gjithësesi, bazimi thuajse tërësisht i financimit në tarifën studentore e bën universitetin shumë të ndjeshëm ndaj regjistrimit të studentëve cdo vit duke ulur aftësinë e tij për të bërë parashikime dhe investime afat-gjata.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim **0.5%**
- Konsulencat, shërbimet Nuk ka
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit **98%**
- Sponsorizimet Nuk ka
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) Nuk ka
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj Nuk ka
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) **1.12%**

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Sic vihet re dhe e theksuam më lartë, burimet financiare vijnë në pjesën dërrmuese nga tarifën e studimit dhe kthehen përsëri tek studenti në shërbimet e ndryshme që ato marrin për të përmbushur ciklin e plotë mësimor. Sipas RVB-së në vitin akademik 2016-2017 kostoja për student është 137,000 lekë.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Gjatë vititës në institucion ne nuk kërkuam një raport auditimi pasi edhe ekspertiza e ekspertëve të jashtëm nuk mundësonte që ne ta analizojm atë (të dy ekspertët janë politologë dhe studiues të marrëdhënieve ndërkombëtare). Nga drejtuesja e burimeve njerëzore na u tha që bëhet një auditim i brendshëm i cili është detyrim ndaj Qendrës “Mesdheu” dhe i jepet bordit drejtues të Qendrës. Duke qënë se mbi 98% e burimeve financiare vijnë nga tarifën studentore dhe aktivitetet tregëtare (vetëm në vitin a kaluar akademik ka patur të ardhura nga grante
<b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	
<b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e	



përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	kërkimore) kriteri 2 nuk ka qenë i nevojshëm për t'u analizuar deri tani.
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	Institucioni argumentoi që ndërmerr hapa proaktivë për të patur pasqyra të qarta financiare dhe se është 'konservator' në menaxhimin e burimeve financiare. Përsa i përket qëndrueshmërisë financiare të programit të studimit nën akreditim, mund të thuhet që numeri i kufizuar i studentëve (3 këtë vit akademik dhe 20 gjatë një periudhe 6 vjecare) e bën qëndrueshmërinë e programit, nga pikpamja financiare, të vështirë. Drejtuesit e UMSH na informuar që UMSH e subvencionon këtë program për të krijuar një fizionomi të caktuar të universitetit dhe se një financim i tillë nuk ndikon negativisht në stabilitetin financiar tërësor të UMSH
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>	
<p>Institucioni ndërmerr një auditim të përvitshëm si detyrim i rregullores që tij dhe detyrim ligjor ku identifikohen burimet e të ardhurave, shpenzimet dhe kostot për student.</p> <p>Institucioni, si pjesë e auditimit të tij, identifikon kostot për programin studimi. Institucioni, në varësi të objektivave të tij, vendos që të mbajë edhe programe studimi të cilat kanë kosto për institucionin sic është rasti i programit nën akreditim.</p> <p><b>Standardet plotësohen plotësisht.</b></p>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

UMSH ka në shtriturën e saj zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave e cila ka për detyrë që të ndjekë dhe sigurojë cilësinë e brendshme si dhe të identifikojë problematikat e ndryshme dhe të udhëzojë (bashkëpunojë) me instancat përgjegjëse për adresimin e problematikave të vërejtura. Në përgjethësi, universiteti, dhe sidomos zyra përkatëse, i kushtonin rëndësi sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe merrnin masa që të bënin kontrollë rutinore për cilësinë dhe të adresonin problemet e identifikuara.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:



- Sa anketime kanë bërë me studentët
- Sa studentë janë anketuar
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

Zyra e kontrollit të brendshëm të cilësisë kryen dy anketime në vit për të gjitha lëndët mësimore në të dy semestrat e vitit akademik. Anketimet kryen në fund të semestrit përpara se studenti të marrë notën në lëndë (për të siguruar sa më shumë objektivitet). Të gjithë studentët që janë të pranishëm në klasë marrin pjesë në anketim rezultatet e të cilit më pas përpunohen nga zyra e sigurimit të cilësisë. Rezultatet i përcillen zyrës së burimeve njerëzore, shëfave të departamentit dhe dekanit ku identifikohen problematikat në rang njësie dhe problematikat më individuale nëse ka të tilla. Këto të dhëna pasi përpunoheshin nga kjo zyrë, dërgoheshin në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Ato behën pjesë e një formulari i cili shte i ndarë në disa seksione si, vëtvlerësimi i pedagogut, vlerësimi i dekanit/shefit të departamentit si edhe pyetësorët e studenteve. Në këtë formuluarpesha që zinin pyetësorët e studentëve ishte rreth 20%, kjo na u konfirmua në takimin me Zyrën e Burimeve Njerëzore. Më pas, shefat e departamenteve bëjnë takime individuale më pedagogët për të identifikuar mënyrat më të mira për të zgjidhur problematikat e identifikuar. Sipas universitetit, në përgjithësi studentët nuk shfaqin problematika shqetësuese në përgjigjet e tyre.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Pjese e kontrollit të brendshëm të cilësisë është edhe kontrolli mbi silabuset. Edhe pse pedagogët janë ekspertë të fushës së tyre ato duhet të ndjekin standardet e aprovuara nga universiteti, qofte në format apo në procedurat e vlerësimit, në mënyrë që të ketë një standardizim pune. Kur zyra identifikon probleme me silabuse të caktuara kontaktohet shefi i departamentit në mënyrë që të zgjidhet çështja.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

NJSBCZHK ka 5 anëtarë nga stafi akademik të cilët ndajnë përgjegjësinë më shpen e zyrës për të kontrolluar cilësinë e brendshme. Bazuar në planin e punës së zyrës ato ndërmarrin hapa për të siguruar cilësinë deri në nivel departamenti. Kjo zyrë ishte riorganizuar në Nëntor të 2017, gjithashtu kishin hartuar edhe miratuar edhe rregulloren e kësaj zyre (manual), kishin përmirësuar pyetësorët e studentëve etj.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Në fund të cdo viti akademik të gjithë anëtarët e stafit plotësojnë një formular vetëvlerësimi (që lidhet edhe me një shpërblim monetar) ku ato vlerësojnë outputin e tyre akademik dhe prezantojnë një plan për vitin e ardhshëm akademik. Raporti vlerësohet nga shefi i departamentit, dekani dhe në fund nga zyra e burimeve njerëzore. Në fund të këtij procesi pedagogu bën një takim me zyrën e burimeve njerëzore ku identifikohen pikat e forta të punës, pikat e dobëta dhe planin për të ecur përpara. Sipas universitetit procesi është kolegjal dhe nuk ka për qëllim ndëshkimin por ndihmën që stafi të avancojë në mënyrë progresive sidomos ato që janë në prag të marrjes së gradës apo kapërcimit të titullit.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Sic është e qartë edhe nga shpjegimet e mësipërme, universiteti ka vënë në jete struktura dhe politika të qarta për të siguruar cilësinë e brendshme ashtu sic e kërkon edhe ligji. Nga vizita konstatoam që gjendja e raportuar rakordonte me atë në terren. Pedagogët bënin vetëvlerësim, zyra e sigurimit të cilësisë kryente sondazhet, dhe në pas të dhënat përpunoheshin deri tek zyra e burimeve njerëzore ku problematikat e identifikuar adresohen në rang individual apo departamental në varësi të problematikës.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Formularë vetëvlerësimi
- Pyetësorë studenti



## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>c. Pyetje konceptuale;</li> <li>d. Intervista;</li> <li>e. Etj.</li> </ul> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</li> <li>b. Dëgjime në auditor;</li> <li>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li> <li>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</li> <li>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</li> <li>h. Etj.</li> </ul>	<p>Institucioni qartësisht kryen procedura të tërthorta dhe të drejtpërdrejta, dhe i ka ato të institucionalizuara.</p> <p>Rezultatet e sondazheve dhe të vetëvlerësimit i bëhen të ditura stafit (për pjesën që i takon secilit) dhe i ofron drejtuesve të njëjësive bazë dhe kryesore. Këto rezultate më pas përpunohen për të krijuar politika të reja apo përmirësuar ato ekzistueset. Shefat e departameneve e pralikojnë procedurën e dëgjimit të leksionit në auditor sidomos për stafin e ri apo të sapo punësuar në universitet. Universiteti nuk bën fokus grupe dhe NJSBCZHK nuk kontrollon korrigjimet e provimeve për të parë nëse ka probleme. Do të ishte mirë që edhe këto praktika të përfshiheshin në procesin e kontrollit të sigurimit të brendshëm të cilësisë pasi ndihmojnë në krijimin e një pasqyre më të plotë të situatës. Një tjetër kompetencë që kishte kjo zyrë ishte edhe rishikimi i silabuseve nga ana formale. NJSBCZHK sigurohej që formati apo zërat që përmbate silabusi të ishin korrekt dhe ata të miratura në rang institucioni.</p>
<b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b>	



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Stafi me të cilët ne diskutuam kishte informacion të qartë për procesin dhe e përshkruar atë në mënyrë të ngjashme me përshkrimin që bënë drejtuesit e universitetit që do të thotë se informacioni është i bollshëm dhe i saktë. Në faqen e internetit të universitetit nuk kishte informacion mbi zyrën e sigurimit të brendshëm të cilësisë apo informacion rreth punës e raporteve të saj.</p>
<p><b>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi MP në marrëdhënie ndërkombëtare ka një strategji zhvillimi i cili është bazuar në analizën, në rang departamenti, mbi ecurinë e programit ndër vite. Departamenti në bashkëpunim me NJSBCZHK analizon problematikat e vërejtura mbi programin dhe ndërmerr hapat përkatëse, ne vizitë u informuar që në përgjithësi universiteti ka një përjasje konservatore dhe ndryshimet bëhen pas konsultimeve të gjera e të gjata dhe ndryshimet bëhen rralle.</p>
<p><b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni është i akredituar në nivel institucional dhe programi gjithashtu. Në përgjithësi institucioni përdor instrumentat e duhura për garantimin e cilësisë. Sic e thashë edhe më lart duhen kontrolluar edhe korrigjimet e provimeve dhe eseve si dhe duhet shtuar elementi i fokus grupeve në matjen e kënaqshmërisë së studentëve.</p> <p>Duke qenë se dhe studentët dhe stafi janë të përfshirë në procesin e matjes së brendshme të cilësisë, edhe me sa pamë nga vizita të dyja palët ishin të informuara mbi këtë proces.</p> <p>Me sa pamë nga dokumentat që na u vunë në dispozicion nuk ka një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë e cila duhet bërë në të ardhmen e afërt.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Sic bëhet e qartë edhe nga përshkrimi i mësipërm institucioni nëpërmjet NJSBCZHK i kushton vëmendje sigurimit të brendshëm të cilësisë, matjes së saj dhe ndërmarrjes së hapave proaktivë për adresimin e problemeve të identifikuara</p>	



Stafi dhe studentët ishin të vetëdijshëm për këtë proces. Stafi, bazuar edhe mbi vetëvlerësimin ishte në proces të vazhdueshëm monitorimi dhe planifikimi pune e cila ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Sugjerohet që në të ardhmen afat-mesme të zgjerohet objektivi me metodat e matjes së cilësisë. Specifikisht duhen përdorur fokus grupet në matjen e kënaqësisë së studentëve me procesin mësimor dhe gjithashtu duhet vlerësuar nga NJSBCZHK te korrigjimit të standardizuar të provimeve nëpërmjet kampionimeve të rastësishme e të herëpashershme.

**Standardet plotësohen plotësisht.**

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi MP në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil Studime Mesdhetare dhe Studime Europiane ka qëllim që të formojë specialistë me orientim praktik në fushat studimore të mësipërme. Sipas raportimeve dhe nga vizita, ishte e qartë që Universiteti synonte të krijonte specialistë me formim praktik që mund të hynin lehtësisht në tregun e punës. Universiteti gjithashtu ka angazhuar edhe një numër pedagogësh të jashtëm me eksperiencë praktike në diplomaci si mësim-dhënës në këtë program.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane, Studime Mesdhetare ka filluar në vitin akademik 2011-2012 ka si objekt studimin dhe kërkimin shkencor duke i trajtuar ato në përputhje me zhvillimet globale dhe në përgjigje të nevojave të tregut të punës.

Ky program është pjesë e kurrikulës të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Programi përputhet me planin afatgjatë dhe afatmesëm të Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë", në kuadrin e prioritetëve të Integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Ky program studimi është i organizuar në lëndë mësimore të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Programi i studimit është i përqëndruar kryesisht në studimin e çështjeve europiane në aspektin e teorive të integritit, të drejtën europiane, politikat publike, teorive të administratës, historisë së qytetërimit mesdhetar, sistemet politike të Mesdheut si dhe Politikave të Bashkimit Europian në Mesdhe.



- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)
  - 1 vit akademik ka 60 javë mësimore në auditor
  - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Në tërësi lëndët e programit mësimor janë të përshtatshme me qëllimet e programit dhe me objektivat e tij. Gjithashtu lëndët kanë tituj të përshtatshëm, të qartë dhe që përshkruajnë në mënyrë korrekte tematikën e lëndës. Temat që identifikohen në silabuse duhet të shoqërohen edhe me disa fjali orientuese dhe sqaruese për studentët si dhe me lërximet përkatëse me faqe specifike.

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:
  - Për leksionet 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit
  - Për Seminaret 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit
  - Për Praktikën Profesionale 21 orë në auditor dhe 4 orë punë e pavarur e studentit
  - Provimi përfundimtar 1 orë në auditor dhe 24 orë punë e pavarur e studentit

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Plotësoni Tabelën në Aneks)

Universiteti nuk kishte bere ndryshime gjatë këtyre viteve në krahasim me programin mësimor të licensuar.

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës
 

Në tërësi edukimi dhe ekspertiza profesionale e pedagogëve ka përshtatshmëri të kënaqshme me lëndët që ato japin leksion. Nga kontrolli që iu bë CV-ve të pedagogëve dhe lëndëve që ato japin u vu re një përpunueshmëri e kënaqshme.

- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.
  - Emërtimi i lëndës/modulit
  - Viti/semestri kur zhvillohet lënda
  - Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
  - Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
  - Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
  - Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
  - Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
  - Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
  - Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
  - Format e vlerësimit të studentëve
  - Detyrimet e studentit për lëndën
  - Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

- Analizë e cilësisë së syllabuseve

Në përgjethësi syllabuset ishin të qartë dhe lehtësisht të kuptueshëm nga studentët pasi pasqyronin mirë objektivat e lëndës, qëllimet e saj si dhe mënyrën e vlerësimit me notë nga profesori i lëndës. Të gjitha syllabuset kishin të njëjtën metodë vlerësimi që e bën më të lehtë për studentët të orientohen dhe të strukturojnë qasjen e tyre ndaj studimeve.

Fatkeqësisht, **asnjë nga syllabuset nuk specifikonte leximet që duhej të bënin studentët për secilën temë leksioni apo seminari** kështu që ishte e pamundur për të krijuar një ide se sa dhe çfarë duhej të lexonin studentët për cdo temë. Gjithashtu syllabuset mund dhe duhej të ishin më të qartë rreth metodave të mësim-dhënies. Specifikisht të gjitha syllabuset pretendonin që do të kishte leksione, diskutime e debate, që bën sens. Por duhet specifikuar më tej nëse do të ketë punë në grup,



punë në terren (meqe është MP) apo instrumenta të tjerë. Besojmë që përfshirja e elementëve të identifikuar do t'i përmirësojë më tej syllabuset dhe do ta bëjë më të lehtë për studentët që të parashikojnë detyrime e tyre akademike.

Në objeksionet e institucionit për draft-raportin e vlerësimit të grupit të jashtëm, nr. prot. 310/12 institucioni informoi që leximet që nuk specifikohen në syllabus komunikohen në orën hyrëse të cdo lënde. Gjithashtu, bazuar në VKM 41 datë 28.01.2018, janë marrë masa që problematikat e identifikuar të adresohen.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Dokumentacioni i paraqitur nga institucioni për syllabuset (te vëna në dispozicion online) ishte i mjaftueshëm dhe nuk u kërkua dokumentacion shtesë. Gjithashtu, bazuar edhe nga diskutimet me GVB si dhe me lektorët e programit, situata e përshkruar në program ishte e ngjashme me atë që u vu re në terren.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Institucioni ofron programe të akredituara. Programi në fjalë është i akredituar VKA Nr. 334, datë 08.06.2012. Programi i studimit bazohet në module të cilat kanë secila një numër të caktuar ECTS të cilat në fund të programit arrijnë në 60 ECTS.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të</p>	<p>Në përgjithësi programi është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit si dhe me kërkesat ligjore për MP. Programi fokusohet në dhënien e dijeve praktike për studentët si dhe në mundësimin e një praktike që t'i thellojë më tej këto dije praktike dhe të mundësoje përfitimin e një vendi pune. Duke qenë se shumica e studentëve që regjistrohen në këtë program janë të punësuar atëhere fokusi është në thellimin e dijeve dhe aftësive të tyre praktike.</p> <p>Përsa i përket përshtatshmërisë së programit me kërkesat e tregut të punës, profili studime mesdhetare paraqitet problematik pasi, edhe nga diskutimet që patëm me stafin, e gjetëm të vështirë të identifikonim mundësi reale punësimi në tregun shqiptar në këtë orientim. Fakti që shumë pak studentë regjistrohen në këtë profil (këtë vit akademik nuk kishte asnjë student) është në vetvete një indikator që duhet bërë një studim më i mirë i tregut dhe ndoshta ky profil duhet të, në një farë mënyre, të rikalibrohet ndaj kërkesave të tregut.</p>



<p>drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Kurrikula e këtij programi ka gjithsej 1 lëndë në disiplina të formimit të përgjithshëm metodologjik (8 ECTS), 2 lëndë të formimit karakterizues me 14 ECTS, 3 lëndë të formimit karakterizues për cdo profil me 18 ECTS që krijojnë 2 profilet si dhe praktikën profesionale me 5 ECTS dhe tezën e diplomës me 8 ECTS.</p>
<p><b>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Në përgjithësi ky standard përmbushet. Sic e thamë edhe më lartë do të ishte mirë nëse në syllabuset e lëndëve të specifikoheshin leximet për cdo javë që të kuptohje më mirë nëse sasia dhe niveli i leximeve është i përshtatshëm me nivelin e programit.</p> <p>Të gjithë syllabuset kishin të njëjtin format vlerësimi për studentët: 60% provimi përfundimtar, 30% detyra e kursit si dhe 10% pjesëmarrja në seminar. Kjo lloj metode vlerësimi është e pranueshme. Ndoshta mund të eksperimentohen edhe emetodat e tjera më moderne për ta bërë më tërheqëse për studentet.</p>
<p><b>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomatat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në</p>	<p>Programi i studimit bazohet në lëndë me syllabuse të cilat kanë programin dhe metodën e vlerësimit të përdorur gjatë lëndës. Cdo syllabus identifikon numrin e leksioneve, seminareve, dhe ECTS të lëndës. Kjo e bën programin lehtësisht të vlerësueshëm ndërkombëtarisht sidomos për sa i përket një transferimi potencial. Duke qenë që programi bëhet në shqip, ndërkombëtarizimi i tij potencial është i kufizuar automatikisht dhe duke qenë që është MP dhe niveli i guhës se huaj që kërkohet për studentët është më i ulët, e bën më të vështirë ndërkombëtarizimin e tij. Mendoj që do të ishte e dobishme që një pjesë e shkurtër e cdo syllabusi të ishte gjithashtu në anglisht që të mundësonte një ndërkombëtarizim më të madh të programit.</p>



legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.	
<b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Duke qenë se programi në akreditim është MP, kishte një theks të vecantë në formimin profesional të studentëve duke i kushtuar hapësirë jo të vogël praktikës. Gjithashtu, duke qenë që është një MP kishte më pak theks ndaj kërkimit shkencor pasi masteri ka një natyrë praktike dhe aplikative.</p> <p>Aftësimi për kërkim shkencor realizohet përmes lëndëve të metodave të kerkimit, seancave metodologjike keshillimore për punimin e diplomës dhe konsultimin e vazhdueshëm me pedagogun udhëheqës.</p>
<b>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Universiteti vinte një theks të vecantë në krijimin e profesionistëve të cilët mund të hynin me sukses në tregun e punës. Sic e thamë edhe me lartë, edhe sic tregohet edhe nga numrat e ulët të studentëve të regjistruar, profili i studimeve mesdhetare duket sikur nuk përmbush një nevojë të tregut shqiptar dhe studentët që diplomohen nga ky program mund të kenë vështirësi jo të vogla për të gjetur hapësira profesionale në tregun e punës në Shqipëri.</p>
<b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Universiteti na informoi që ka bërë sondazhe të ndryshme për të identifikuar nevojat dhe hapësirat në tregun e punës shqiptar. U informuam që MP synonte prodhimin e profesionistëve që mund të punonin në sektorin diplomatik, organizatat jo fitimprurëse, think tanks, akademi, apo edhe organizata rajonale. Gjithësesi numri i ulët i të regjistruarve tregon se studentët nuk shikojnë të njëjtin potencial në këtë program studimor.</p>
<b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i sutimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe ndihmon në përcimin dhe ruajtjen e vlerave tona kulturore kombëtare</p>



**Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.**

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Kriteri përmbushet për programin. Specifikisht studentët ndërmarrin 7 lëndë me nga 8 deri në 6 kredite secila dhe një praktikë e cila ka 5 kredite si dhe provimi përfundimtar me 8 kredite për një total prej 60 kreditesh. Organizimi i programeve të studimit realizohet nëpërmjet moduleve dhe Sistemit European të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS). Një kredit universitar përkon deri me 25 orë pune të studentit, përfshirë këtu dhe kohën për studim individual.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi</p>

**Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p>	<p>Nga zyra për kujdesin ndaj studentit u informuam që studentët potencialë e marrin të gjithë informacionin nga zyra e informimit të studentëve, e cila i orienton studentët pranë departamenteve për informacion me specifik. Pasi regjistrohen informacioni mbi programin e lëndën ofrohen nga përgadegu dhe departamenti në klase, zyrë, dhe online.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	

**Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.**

<p><b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p>	<p>Programi në fjalë ka një strukturë të qartë studimore për cdo semestër ku parashtrihen edhe detyrimet që duhen përmbushur për të kaluar cdo etapë dhe për t’u diplomuar. Në përfundim të studimeve studentët mbrojnë temë diplome.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	

**Konkluzionet e vlerësimit:**  
 Në përgjethësi programi i përmbush kërkësat ligjore (nr i krediteve, ruajtja e vlerave kulturore, aftësimin profesional, dhe përputhja me strategjinë e institucionit) bazuar në dokumentacionin e ofruar si dhe



vizitën në terren.

Programi, sidomos profili studime mesdhetare, duket sikur nuk përmbushin një kërkesë të tregut të punës, e cila reflektohet edhe në numrin shumë të ulët të studentëve të regjistruar.

Ndoshta, një analizë më e plotë e tregut të punës dhe një ridimensionim i programit bazuar në këtë studim mund të rrisë numerin e studentëve dhe si rrjedhojë edhe efikasitetin e tij.

**Rekomendohet** që silabuset të jenë më konkrete dhe të detajuara. Specifikisht, duhet bërë një përshkrim i shkurtër i secilës temë që trajtohet në leksion dhe seminar si dhe duhen specifikuar numri i faqeve që do të lexohet për çdo leksion nga studentët. Gjithashtu duhet identifikuar me qartë metoda që do të përdoret për çdo leksion e seminar e cila duhet të përshtatet me temën e trajtuar si dhe llojin dhe sasinë e leximeve të dhëna si detyrë.

**Standardet plotësohen kryesisht.**

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia realizohet nëpërmjet lëndëve të miratuara dhe të përcaktuara në programin mësimor Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane, Studime Mesdhetare. Format e mësimdhënies të aplikuara në programin e studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane; Studime Mesdhetare janë leksionet, seminarët, praktika profesionale dhe orët e konsultimit të pedagogëve me studentët.

Leksionet dhe seminarët zhvillohen në formë interaktive duke i bërë studentët pjesë aktive të këtij procesi duke u përpjekur që orët e mësimit të jenë sa më dinamike dhe realizojnë me efektivitet qëllimin e tyre. Seminarët janë të përqëndruara kryesisht në diskutimin e materialit të leksionit si dhe detyrat specifike të lëna për studentët. Pjesë e rëndësishme e seminarëve mbetet shpejgimi i çështjeve të cilat studentët kanë hasur paqartësi gjatë leximit të materialeve. Pjesëmarrja në seminare është e detyrueshme deri në masën e parashikuar në programin e lëndës si dhe aktivizimi dhe në seminare ka peshën specifike të vlerësimit final të studentit.

Ngarkesa mesimore ndahet ndërmjet pedagogëve duke u bazuar tek kërkesat ligjore mbi ngarkesën mesimore që duhet të plotësoj cdo pedagog. Për shpërndarjen e lëndëve merret në konsideratë ekspertiza dhe fusha kërkimore dhe kualifikimi shkencor i cdo pedagogu me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Pedagogët e e punësuar me kohë të plotë mbulojnë 78% të ngarkesës totale të mësimdhënies dhe pedagogët me kontratë mbulojnë 22% të ngarkesës mesimore (për vitin akademik 2017-2018).

Cilësia e realizimit të ngarkesës mesimore: Për të garantuar cilësinë e realizimit të ngarkesës mesimore në disa raste është ndjekur dhe mënyra e realizimit të orës së mësimit nga pedagogu nëpërmjet vizitave gjatë zhvillimit të orës. Gjithashtu dhe formulari mbi vlerësimin e performancës së pedagogut është një tregues për cilësinë e realizimit të ngarkesës mesimore.

Metodat e mësimdhënies: Leksionet dhe seminarët mbeten metoda klasike e mësimdhënies. Kjo metodë është alternuar me diskutimet e vazhdueshme në klasë. Mendojmë se debatet në grupe por dhe simulimet mbeten një metodë jo shumë e zhvilluar në këtë pasi numri i ulët i studentëve i kufizon



praktika të tilla si dhe realizimin sa më efikas të tyre. Leksionet e hapura me ekspertë apo personalitete të fushës janë një praktikë e vlefshme nga të cilat përfitojnë dhe studentët e programit.

Vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies realizohet në ndjekjen e njoftuar të orëve të mësimit nga Përgjegjësi i Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare si dhe nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Në kontrollet e realizuara gjatë orëve të mësimit mbahen shënime të cilat ju referohen drejtuesve të institucionit duke nisur nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet e studentëve merren në konsideratë në kuadrin e vlerësimit të brendshëm të mësimdhënies. Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë. Në Fakultet ndiqet praktika e promovimit dhe ofrimit të mundësisë së aktivizimit të studentëve në aktivitete të njësisë, vecanërisht atyre me rezultate të larta.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet Aneks/ Tabela 9

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Detyre
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

Format e kontrollit të njohurive Aneks Tabela 10

Për kontrollin e njohurive përdoren kryesisht metoda e provimit final, provimit në mes të semestrit , detyra e kursit si dhe aktivizimi në seminar. Një element i rëndësishëm i cili përforëcon aftësitë praktike të studentëve është dhe praktika mësimore e cila zhvillohet nëpërmjet marrëveshjeve që ka UMSH me institucione të ndryshme. Ka përpjekje të vazhdueshme për t'i angazhuar studentët në aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me projekte në rang fakulteti .

Aneks tabela 12

## **9. Studentët**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit bëhet publike në faqen zyrtare të UMSH, në broshurat informuese të cilat gjenden pranë sekretarisë si dhe gjatë fushatës mediatike.

Pranimi është mbështetur në statutin e UMSH dhe në rregulloren e prgramit të studimit. Pranohen të gjithë ata studente që janë diplomuar "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ETCS. Bazuar në rregulloret e programeve të studimit institucioni shpall kriteret specifike të pranimit. Përzgjedhja e



kandidatëve për pranim në cdo fakultet bëhet nga një komision i caktuar nga dekani, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur si dhe vlerësimin e dosjes personale të kandidatit.

### **Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

Procedurat e pranimin të studentëve

Kandidati fiton statusin e studentit kur: a) regjistrohet në sekretarinë mësimore në përputhje me procedurën ligjore të regjistrimit; b) dorëzon dokumentacionin e kërkuar; c) paguan tarifën e regjistrimit; d) nënshkruan kontratën e studimit. Statusi i studentit përfundon me diplomimin ose me përjashtimin e tij nga UMSH për arsye objektive.

Kushte specifike të pranimin të studenteve.

Bazuar në rregulloren organizative të UMSH, neni 51, kushtet specifike të pranimin të studentëve në programin e studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane; Studime Mesdhetare janë: a) kandidatët duhet të kenë përfunduar studimet universitare të ciklit të parë në përputhje me aktet ligjore dhe Rregulloren e programit të studimit; b) pranimi bëhet në përputhje me specifikat e programit bazuar në rregulloren e tij, nevojat e tregut, mundësitë akademike dhe infrastrukturore të institucionit; c) kriter ligjor i pranimin në programin e studimit

**Numri total i të diplomuarve është 17.**

Nuk ka një evidencë të saktë të numrit total të të punësuarve. Zyra e Zhvillimit të Karrierës punon për krijimin e ALUMNI me takime të përvitshme si dhe një database me punësimin e të diplomuarve, porn ë shumicën e rasteve të dhënat mungojnë për shkaqe nga më të ndryshmet përfshi edhe ndryshimet e vazhdueshme të kontakteve.

Nota mesatare e studentëve në hyrje prej vitit akademik 2012-2013 ka qenë mbi 7. Në vitin akademik 2017-2018 nota mesatare hyrëse e studentëve në këtë program studimi është 7.16. numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin e parë të vitit akademik 2017-2018 është 3. Të diplomuar vitin akademik 2016-2017 janë 7 studentë.

Bazuar në rregulloren organizative të UMSH, neni 51, kushtet e pranimin të studentëve në programin e studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane; Studime Mesdhetare janë: a) kandidatët duhet të kenë përfunduar studimet universitare të ciklit të parë në përputhje me aktet ligjore dhe Rregulloren e programit të studimit; b) pranimi bëhet në përputhje me specifikat e programit bazuar në rregulloren e tij, nevojat e tregut, mundësitë akademike dhe infrastrukturore të institucionit; c) kriter ligjor i pranimin në programin e studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane; Studime Mesdhetare është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të Bashkimit Europian.

Kandidati fiton statusin e studentit kur: a) regjistrohet në sekretarinë mësimore në përputhje me procedurën ligjore të regjistrimit; b) dorëzon dokumentacionin e kërkuar; c) paguan tarifën e regjistrimit; d) nënshkruan kontratën e studimit

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare Aneks/ Tabela 12

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend  
Studentët kanë mundësi për tu përfshirë në projekte të ndryshme brenda institucionit si dhe të financohen prej tij për pjesëmarrjen në kualifikime të mëtejshme. Disa ish studentë janë punësuar pranë UMSH.



Numri total të diplomuarve

Në këtë program ndër vite janë diplomuar 17 studentë. Për sa i përket punësimit të tyre duke ju referuar RVB por edhe vizitës së kryer në institucion mungojnë të dhënat e sakta në raport me këtë tregues. Përgjithësisht studentët të cilët ndjekin këtë program studimi janë të punësuar gjatë kohës së zhvillimit të programit.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p>	<p>Studentet që ndjekin programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombetare me profil: Studime Europiane; Studime Mesdhetare kanë si detyrim të kenë përfunduar studimet universitare në nivel bachelor dhe të kenë grumbulluar 180 ECTS.</p> <p>Pranimi i studentëve në programet e integruara që ofron universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" bëhet në përputhje me ligjin 80/2015, si edhe aktet nënligjore në fuqi, dhe pasi është bërë kontrolli i dosjes me dokumentacionin e kërkuar.</p> <p>Pranimi në ciklin e dytë të studimeve bëhet në përputhje me specifikat e programit, mundësitë akademike, nevojat e tregut si dhe mundësitë infrastrukturore të institucionit. Bazuar në rregulloret e programeve të studimit institucioni shpall kriteret specifike.</p> <p>Të pranimit (<i>Aneksit 4 rregullore e programit të studimit Master Profesional ne Marrëdhënie Ndërkombëtare</i>).</p> <p>Sipas Udhëzimit të Ri të MARS provimi i gjuhës së huaj nuk është më kriter për të pranuar studentët në programin e Masterit Profesional, ndaj patja e certifikatës së gjuhës angleze nga studentët e programit shikohet si një faktor pozitiv.</p> <p>Përzgjedhja deri në momentin e vizitës vlerësuese është bërë në bazë nevojash të institucionit, megjithatë numri i vogël i studentëve në këtë program mendoj se kërkon një rivlerësim të nevojave të tregut dhe përshtatjes së tyre me këtë fushë studimesh.</p> <p>E njëjta gjë mendojmë se duhet të reflektohet në politikat e pranimit dhe në ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p>	
<p><b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p>	
<p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p>	
<p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	



	të studentëve në programin e studimit duke patur në konsideratë në cdo rast ruajtjen e cilësisë në këtë proces.
<b>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Në UMSH zyra e këshillimit të studenteve dhe karrierës mbështet studentet gjatë kohezgjatjes së studimeve të tyre si dhe orienton ata në mundësitë për kryerjen e studimeve të mëtejshme të doktoratures. Gjithashtu kjo strukturë, stimulon studentet të marrin pjesë në programe dhe konkurse kombëtare, ndërkombëtare.</p> <p>Për avancimin e mëtejshëm të karrierës shihet pozitiv fakti i bashkëpunimit të UMSH dhe me sektorin privat. Gjithsesi konsiderojmë të rëndësishëm faktin se një database i saktë në raport me studentët e diplomuar dhe karrierën e tyre do të nxjerrë më qartë në pah suksesin e institucionit në këtë fushë.</p>
<b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash mbi numrin e studentëve të në cdo program studimi. Studentët të cilët nuk arrijnë të përfundojnë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, kanë të drejtë të aplikojnë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër duke ju nënshtruar kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programet e studimit të ofruara nga UMSH.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim. Përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me sekretarinë mësimore është i informuar mbi ecurinë e studentëve.</p>
<b>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Institucioni përpiqet të mbajë në vazhdimësi statistika për karrierën e studentëve të tij, nëpërmjet kontakteve me ta edhe pas mbarimit të studimeve. Rezulton se për shkaqe nga më të ndryshmet, përfshi edhe ndryshimet e vazhdueshme të kontakteve të studentëve nuk ka një statistikë egzakte të personave të punësuar apo rrugës profesionale të ndjekur pas përfundimit të studimeve në UMSH.</p>



	<p>UMSH zhvillon aktivitete me institucione shtetërore, kompani private që synojnë nxitjen e punësimit të studentëve.</p> <p>UMSH njëkohesisht ka ndjekur politika favorizuese të punësimit të studentëve më të mirë edhe brenda institucionit</p>
<p><b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët informohen mbi programin e lëndëve, mënyrën e zhvillimit të tyre, mënyrën e vlerësimit dhe kriteret e vlerësimit. Studentën janë në dijeni mbi afatet e programit si dhe statusin në të cilin ndodhet akreditimi institucional dhe i programit të studimit.</p> <p>Studentët informohen në mënyrë transparente mbi vlerësimin e tyre gjatë programit si dhe në përfundim të tij. Pedagogu diskuton me studentët si dhe shpjegon rezultatet e vlerësimeve.</p>
<p><b>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Administrata e institucionit ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët në këshillimin por edhe në zgjidhjen e problematikave të ndryshme që lidhen me procesin mësimor dhe mbarëvajtjen e tij.</p> <p>Përzgjedhja e praktikës profesionale zhvillohet në bashkëpunim me zyrën e këshillimit të karrierës duke patur në konsideratë mundësitë e institucionit si dhe preferencën e studentit. Në këtë funksion cdo të premtë zhvillohen takime ku studentët këshillohen dhe në raport me zgjedhjen e saj.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Prioriteti i programit të studimit është studenti. Informacioni, mbështetja, transparenca janë element të cilët shoqërojnë studentët që nga regjistrimi i tyre në këtë program studimi e deri në përfundim të tij. Një rëndësi e vecantë i kushtohet praktikës mësimore dhe aktiviteteve ekstrakurikulare. Në sekretarinë mësimore egziston dosja personale e secilit student e mbajtur në mënyrë të rregullt sipas parametrave të kërkuara nga ligji dhe rregullorja e UMSH. Në sekretarinë mësimore egzistojnë të dhëna ku pasqyrohen rezultatet e secilit student sipas lëndëve dhe viteve akademike.</p> <p>Numri i ulët i studentëve sjell vështirësi në arritjen e një suksesi në promovimin e këtij programi prandaj <b>rekomendohet</b> që të rritet numri i studentëve në program.</p> <p><b>Standardet plotësohen kryesisht.</b></p>	



## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 10. Kërkimi shkencor

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Bazuar ne RVB si dhe në zivitën në institucion, UMSH i kushton rëndësi kërkimit shkencor si dhe outputeve të matshme të kërkimit shkencor. Universiteti si dhe njësia bazë ndërmarrin një numër aktivitetesh me qëllim kërkimin shkencor dhe prezantimin e gjetjeve të kërkimit shkencor ndaj kolegëve dhe botës jashtë universitetit. Gjithashtu vihet re një përpjekje që ekspertiza kërkimore e pedagogëve të përshtatet me lëndët që ato japin. Në kuadër të MP në akreditim kjo përpjekje është më e theksuar për të përshtatur eksperiencën profesional më lëndën. Gjithësesi, sic do të vihet re më poshtë, universiteti duhet të vendosë një theks më të madh ndaj cilësisë së kërkimit shkencor dhe cilësisë së medimeve në të cilat bëhet botimi.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabelat ne aneks)

Gjendja në terren ishte ashtu sic reflektohej në RVB. Sic e tregonin edhe të dhënat e universitetit kishte një theks në sasi të botimeve dhe jo domosdoshmerisht cilësi. Kur grupi I RVB-se u pyet se çfarë llogaritej si botim shkencor, u informuam që edhe artikujt në gazeta numuroheshin si të tillë gjë që nuk është një praktikë normale ndërkombëtare. Gjithashtu, nuk u identifikua ndonjë artikull i botuar në medime akademike të rankuara. Bazuar edhe në VKM 112 për titujt dhe gradat kjo praktikë duhet të ndryshojë. Duke qenë se VKM 112 nuk ka qenë në fuqi gjatë periudhës për të cilën po akreditohet programi, kjo nuk është një shkelje por një sugjerim të praktikave që duhet të ndryshojnë në të ardhmen përta i përket kërkimit shkencor në UMSH.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;	Personeli në përgjethësi angazhohej në botime në revistën e universitetit si dhe në botime tekstesh po nga shtëpia botuese e universitetit. Ajo që linte vend për pëmirësim ishte procesi i vlerësimit profesional paraprak të artikujve nëse ishin gati për botim dhe nëse kontribuonin në avancimin e dijes shkencore. Universiteti na informoi, edhe nëpërmjet objeksioneve mbi draft-raportin, që botimet e artikujve dhe librave nga shtëpia botuese e UMSH kalojnë
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	



	në një procedurë vlerësuese profesionale. Për ta institucionalizuar më tej këtë proces duhen përgatitur formularë-tip vlerësues të punimit shkencor, duhet ngritur një rrjet i brendshëm vlerësuesish shkencorë, si dhe duhen bërë publik paraprakisht kriteret e botimit në mediumet e UMSH.
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Në RVB-në e programit ishte identifikuar nga GVB-ja si pikë e dobët ndërkombëtarizimi. Duke qenë se institucioni e ka identifikuar vetë si një pikë të dobët - që nënkupton se e ka objektiv - do të thotë se duhet të paktën të ofrojë lëndë në gjuhë të huaj si parakusht për ndërkombëtarizim. Pavarësisht se stafi akademik, në shumicë, kishte kryer të paktën një cikël studimit jashtë shtetit, vumë re që nuk ofronte mësim-dhënie në gjuhë të huaj. Nëse programi do të vazhdojë të ketë si objektiv ndërkombëtarizimin atëhere duhet të ofrojë lëndë në gjuhë të huaj.</p> <p>Programi ofronte lëndë për gjuhë të huaj që kryej nga staf që kishte arsimin përkatës.</p>
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Universiteti i ofronte mundësinë stafit, nëpërmjet procedurave <i>ad hoc</i>, që të merrte pjesë në trajnime jashtë vendit për kërkim shkencor. Me sa kuptuam nga vizita, pavarësisht se UMSH nuk kishte një strukturë për kërkimin shkencor, nuk kishte një strategji të qartë për të trajnuar stafin e tij për ndërmarrjen e kërkimit shkencor.</p>
<b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni e disponon një bazë të dhënash për botimet e stafit të tij pasi stafi në fund të çdo viti akademik bën një vetë-deklarim, ndër të tjera, botimeve shkencore. Institucioni gjithashtu disponon një bazë të dhënash të projekteve që ka fituar pasi aplikimet bëhen në mënyrë të centralizuar.</p>



### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Universiteti ka vendosur kërkesa ndaj stafit akademik për të patur një lloj produktiviteti të ndërmarrjes së kërkimit shkencor gjatë një viti akademik dhe i kërkon stafit të raportojë aktivitetin shkencor mbi bazë të të cilit ofron dhe një kompensim financiar.

Universiteti nuk ka asnjë strategji të qartë të kërkimit shkencor dhe trajnimeve që do t'i orfrojë stafit për rritjen e cilësisë së botimeve.

Universiteti nuk ka një strategji të qartë për rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor si një instrument për promovimin akademik i institucionalizuar në VKM 112.

Duke qënë se programi nën akreditim është MP me fokus në praktikë dhe jo kërkim, problematikat e kërkimit shkencor të identifikuar me lartë nuk e afektojnë shumë negativisht. Gjithësesi, për mbarëvajtjen e punës në tërësi rekomendojmë si me poshtë:

**Rekomendohet** që universiteti të ndërtojë një strategji për kërkimin shkencor bazuar në kërkesat e VKM 112 datë 23.2.2018 si dhe të ketë një kalendar trajnimesh profesionale dhe metodologjike për kërkimin shkencor dhe botimet në revista me fakto impakti Thomson Reuters.

Gjithashtu, duke patur parasysh objektivat e universitetit për ndërkombëtarizim të programit, sugjerohet që të ofrohen lëndë në gjuhë të huaj.

**Standardet plotësohen kryesisht.**

## **11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**

### **Pjesa përshkrimore**

